



Breaking News:

Mat – Policia identifikon, kap dhe shoqëron në Komisariat, autorin e dyshuar të ngritjes së një mjeti inteligjent (dron), mbi ambientet e IEVP Burrel



Lajmet

10/09/2024

Vlorë – Kërcënoi Me Armë Zjarri Fqinjin E Tij, Arrestohet 51-Vjeçari

Vlorë

Falë ndërhyrjes në kohë dhe veprimeve profesionale të shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Vlorë, u parandalua një krim që mund të kishte pasoja të rënda për jetën.

Arrestohet 51-vjeçari që kërcënoi të vriste fqinjin me armë zjarri.

Sekuestrohet një armë zjarri kallashnikov dhe fishekë në banesën e të dyshuarit.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë, në vijim të punës për garantimin e sundimit të ligjit në territor, pas informacionit të marrë se një shtetas posedonte armë zjarri dhe kishte konflikt me fqinjin e tij, konflikt ky që kishte arritur në kërcënime serioze për jetën, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Strike 21”, në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

E. B., 51 vjeç, banues në Vlorë.

Gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri kallashnikov, të fshehur në një fuçi, së bashku me dy krehëra dhe 75 fishekë.

Materialet procedurale u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Policia e Shtetit, plan masash për ndeshjen ndërkombëtare të futbollit Shqipëri – Gjeorgji

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Stacioni” ▶